



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI



Nr. 160 / prot.
4

Tiranë, më 31.12. 2018

UDHËZIM

Nr. 9, datë 31.12.2018

PËR

PROCEDURAT DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 13, pika 2, germa "f", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 4, të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

U DHË ZO J:

KREU I TË PËRGJITHSHME

1. Hyrje.

Në kushtet e një profesionalizmi më të lartë të FA-së dhe një angazhimi gjithnjë e më të madh në përbushje të detyrave në mbrojtje të vendit dhe në interes të Aleancës, rekrutimi i ushtarëve me një profil sa më të lartë është thelbësor për FA-në. Ushtritë e vendeve të NATO-s i kushtojnë një vëmendje të madhe këtij problemi, në mënyrë të veçantë instrumenteve të përzgjedhjes dhe motivimit të tyre. Rekrutimi i ushtarëve/datarëve ka një impakt të rëndësishëm mbi të ardhmen e FA-së. Për këtë arsyesh kërkohet që të rekrutohen shtetas me një profil cilësor, të aftë nga ana fizike dhe shëndetësore dhe me një nivel të lartë kulturor. Një gjë e tillë mund të arrihet nëpërmjet përsosjes së sistemit të përzgjedhjes dhe motivimit.

2. Qëllimi.

Udhëzimi "Procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/datarëve aktivë në FA" përcakton parimet, objektivat, standarde, përgjegjësitë, kryerjen e procedurave dhe zbatimin e kritereve për rekrutimin e ushtarëve/datarëve aktivë.

3. Parimet.

Rekrutimi për t'u bërë ushtar/datar aktiv në Forcat e Armatosura duhet t'u ofrojë shanse të barabarta të gjithë shtetasve shqiptarë për mosdiskriminim për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, vendbanimit, si dhe pagës, përfitimeve dhe kompensimeve të tjera, sipas veçorive të shërbimit ushtarak.

Procedurat e përgjedhjes së ushtarëve/datarëve do të janë transparente dhe të dokumentuara. Për të rritur transparencën, procedurat, kriteret, udhëzimet, rregulloret e testimeve dhe lista përfundimtare e rezultateve të testimit do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të Forcave të Armatosura dhe do të përmirësohet mënyra e zhvillimit të testimit dhe vlerësimit nëpërmjet sistemit të automatizuar.

4. Fusha e zbatimit.

Kërkesat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e politikës dhe procedurave të rekrutimit janë: Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse dhe komandat e njësive dhe reparteve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM, Drejtoria e Personelit në SHP, Drejtoria e Logistikës në SHP, Qendra e Personel-Rekrutimit, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së, Agjencia e Inteligencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Batalioni i Shtabit të Përgjithshëm, Policia Ushtarake dhe Njësia Mjekësore Ushtarake.

5. Objektivat:

- a) rritja e standardeve të rekrutimit, përsosja e sistemit të përgjedhjes, përmirësimi i instrumenteve të testimit dhe vlerësimit, trajnimi sipas specialitetave dhe krijimi i mundësive për karrierë do të bëjnë të mundur rekrutimin e shtetasve me një profil cilësor, fizik dhe intelektual;
- b) rekrutimi i ushtarëve/datarëve aktivë për misionet dhe sfidat e reja që do të përballojnë Forcat tonë të Armatosura, do të bëhet duke ruajtur e duke zhvilluar balancat midis kërkesës për moshë mesatare sa më të re në FA dhe nevojës për të qëndruar më gjatë në shërbimin ushtarak; raporte të arsyeshme midis forcave operacionale e forcave mbështetëse, midis strukturave të shtabeve me trupën, me qëllim përgjedhjeje sa më efektive nga kontingjentet që aplikojnë për të shërbyer në Forcat e Armatosura;
- c) rekrutimi sipas nevojave dhe mbi bazën e specialitetave të Forcave të Armatosura, do të jetë synimi kryesor i procedurave të rekrutimit. Për këtë arsyе përparësi do t'i jepet rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë dhe me aftësi të mira për specialitete të veçanta;
- ç) rekrutimi i ushtarëve femra në FA do të përbëjë 15 % të numrit të përgjithshëm për çdo strukturë operacionale të kërkuar, me synimin për t'u rritur nga vit në vit. Do të inkurajohet rekrutimi i kandidatëve femra për përfshirjen e tyre në strukturat operacionale dhe njësitë e repartet e luftimit;
- d) do të nxitet interes i shtetasve për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura, nëpërmjet zhvillimit të një marketingu sa më efektiv.

6. Strukturat, autoritetet dhe përgjegjësítë.

6.1 Strukturat përgjegjëse për rekrutimin e shtetasve në FA janë:

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DMBNJSH);
- Drejtoria e Personelit në SHP (J-1);
- Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR);
- Drejtoria e Logistikës në Shtabin e Përgjithshëm (J-4);
- Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS);
- Komandat e Forcave/Komandat Mbështetëse (KF/KM);
- Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA-së;
- Qendra e Automatizimit dhe e Mbrojtjes Kibernetike/Kriptografike në ASNI;
- Agjencia e Intelligencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM);
- Policia Ushtarake (PU);
- Njësia Mjekësore Ushtarake e Forcave të Armatosura (NJMU);
- Batalioni i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (BSHP).

a) Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përgjigjet për:

- hartimin dhe rishikimin e procedurave dhe kritereve për rekrutimin e ushtarëve/datarëve aktivë në FA;
- monitorimin e zbatimit të procedurës dhe kritereve;
- mbështetjen e QPR-së me specialistë përgatitjen dhe zhvillimin e testeve në fushën e testimit psikologjik.

b) Drejtoria e Personelit në Shtabin Përgjithshëm të FA (J-1) përgjigjet për:

- zbatimin e procedurave dhe kritereve të rekrutimit të ushtarëve në FA;
- planifikimin e nevojave të rekrutimit dhe dërgimin e planeve vjetore të rekrutimit komandave të interesuara dhe QPR-së;
- përgatitjen e urdhrit për rekrutimin e kandidatëve për ushtarë/datarë aktivë dhe zhvillimin e stërvitjes individuale bazë, të ndarë me struktura, specialitete dhe rajone rekrutimi;
- ndarjen me specialitete të kandidatëve në përfundim të stërvitjes individuale bazë;
- përgatitjen e praktikës së titullimit, gradimit dhe shpërndarjes së tyre;
- përgatitjen e urdhreve për ndërprerjen e stërvitjes individuale bazë dhe të shërbimit aktiv.

c) Drejtoria e Logistikës në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-4), në bashkëpunim me J-1 në SHP, QPR-në dhe KDS-në merr masa për kompletimin me veshmbathje dhe transport për kandidatët fitues, që do ndjekin stërvitjen individuale bazë, në Shkollën e Trupës. Përgatit urdhrin e SHSHPFA-së për vënie mjetesh në dispozicion të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, për transportimin e kandidatëve për ushtarë/datarë, për në Shkollën e Trupës, në Bonavi.

ç) **Qendra e Personel-Rekrutimit** përgjigjet për:

- rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura, mbi bazën e planit vjetor të rekrutimit, të detajuar me specialitete dhe kuota numerike;
- shpalljen në faqen e internetit të MM-së të procedurës, të kritereve të rekrutimit, të dokumentacionit dhe afatit të dorëzimit, testimet që do kryhen dhe mënyra e vlerësimit të tyre, si dhe kuotat sipas specialitetave dhe rajoneve të rekrutimit etj.;
- administrimin e dokumenteve të aplikantëve, verifikimin e vërtetësisë së tyre, si dhe hedhjen e të dhënavët në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- zhvillimin e testimit fizik, testimit psikologjik, testimit intelektual të përgjithshëm, testimit intelektual, testimit profesional, sipas specialitetave dhe shpalljen e rezultateve të tyre;
- dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP të “Raportit të rezultateve përfundimtare”;
- marketingun për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura në bashkëpunim me J-1 dhe J-9 në SHP, Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeun e FA-së dhe Komandat e forcave/reparteve ku bëhet rekrutimi;
- dërgimin në AISM dhe PU të listës së kandidatëve fitues, me të dhënat e sakta personale, përvendbanimin, arsimimin, sipas dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, 45-60 ditë përpëra fillimit të stërvitjes individuale bazë;
- dërgimin në Drejtorinë e Personelit në SHP, pas dërgimit nga AISM-ja dhe PU-ja, të listës përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas kuotave të planit të rekrutimit të miratuar, që do të ndjekin stërvitjen individuale bazë.

d) **Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA-së** bashkëpunon me QPR-në për organizimin e marketingut dhe promovimin e vlerave të FA-së dhe komandantët e forcave/reparteve.

dh) **Komandat e Forcave/Komanda Mbështetëse/Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes**, si dhe Komandat e reparteve mbështesin Qendrën e Personel-Rekrutimit në veprimtarinë e saj.

- KDS-ja, në bashkëpunim me DAPSU-n, QPR-në dhe J-1, është përgjegjëse për hartimin dhe përditësimin e testeve intelektuale për pranimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë në FA.
- KDS-ja është përgjegjëse për dërgimin e rekrutëve në Shkollën e Trupës në Bonavi, kompletimin me uniformë, akomodimin e tyre, si dhe për zhvillimin e stërvitjes individuale bazë.

- Me përfundimin e stërvitjes bazë, KDS-ja i propozon Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, titullim e rekrutëve “ushtar/detar” aktiv dhe dërgon dokumentacionin e përfundimit të kursit në QPR, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij.
 - Pas titullimit “ushtar/detar” dhe dhënies së gradës “ushtar/detar I” ose “ushtar/detar II”, komandat bëjnë emërimin e ushtarëve dhe dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në Qendrën e Personel-Rekrutimit.
- e) **Agjencia e Intelligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Policia Ushtarake (PU),** në bashkëpunim me struktura të tjera, të bëjë kontrollin e plotësimit të kushtit të sigurisë për kandidatët për rekrutë. Kontrolli i verifikimit të kushtit të sigurisë bëhet 60-10 ditë përpëra fillimit të stërvitjes individuale bazë dhe daljes së urdhrit. Policia Ushtarake, gjithashtu, përgjigjet edhe për mbajtjen e rregullit, disiplinës dhe sigurimin e procesit, sipas procedurave standarde. Lista e verifikimit të kontrollit të plotësimit të kushtit të sigurisë të kandidatëve të përzgjedhur për ushtarë/detarë nga AISM-ja dhe PU-ja, të dërgohen në Qendrën e Personel-Rekrutimit, 10 ditë para fillimit të SIB.
- ë) **Njësia Mjekësore Ushtarake e FA-së (NJMU),** pranë Spitalit Universitar të Traumës, përgjigjet për kryerjen e kontrollit fiziko-shëndetësor të shtetasve kandidatë për ushtarë/detarë aktivë, të cilët janë shpallur fitues pas përfundimit të testimeve;
- f) **Batalioni i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së** vë në dispozicion të QPR-së gjatë ditëve të testimit fizik një ambulancë dhe personelin mjekësor të nevojshëm, merr masa për lejimin e futjes së kandidatëve në garnizon për testim, si dhe merr pjesë në procesin e rekrutimit të personelit të orkestrës frymore, me anë të Këshillit Artistik.

KREU II PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE

1. Procedurat e planifikimit për ushtarët/detarët aktivë.

- a) Në periudhën **prill-maj** të çdo viti, Komandat e Forcave, Komanda Mbështetëse, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Komandat e reparteve dhe strukturave të tjera, paraqesin pranë Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1), nevojat dhe kërkesat për kompletimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve me ushtarë/detarë aktivë për vitin pasardhës, sipas prioriteteve, specialiteteve dhe kërkesave përmbytje; nevojave;
- b) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, mbi bazën e nevojave dhe kërkesave, harton planin e rekrutimit, duke marrë në konsideratë prioritetet e përcaktuara, specialitetet, nevojat organike për çdo forcë, njësi e repart dhe numrin e personelit femër që duhet të rekrutohet. Plani i rekrutimit miratohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ndahet me periudha;

- c) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, në muajin qershor, dërgon planin e rekrutimit në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes për të planëzuar stërvitjen individuale bazë dhe stërvitjen individuale të avancuar në bazë të kapaciteteve stërvitore;
- ç) Qendra e Personel-Rekrutimit, në zbatim të planit të rekrutimit, të miratuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, bën rekrutimin sipas rajoneve dhe specialiteteve, të kandidatëve për ushtarë/datarë aktivë, për kompletimin e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura;
- d) Qendra e Personel-Rekrutimit dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, bashkërendojnë planifikimin, me qëllim që, menjëherë pas rekrutimit të kandidatëve për ushtarë/datarë aktivë, të fillojë stërvitja individuale bazë dhe stërvitja individuale e avancuar e tyre.

2. Kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve /datarëve aktivë.

Për t'u rekrutuar në FA si ushtar/datar aktiv, shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të mos jetë në ndjekje penale;
- të mos jetë në proces gjyktimi penal nga gjykata;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të mos ketë probleme me deportimin;
- të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin;
- të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimitari të kundraligjshme apo kriminale;
- mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/datar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/datar aktiv, të cilët do të janë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit;
- të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat ;
- të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/datar aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak.
- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

3. Procedura e aplikimit për ushtar/datar aktiv.

- a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në FA si ushtar/datar aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejt në Qendrën e Personel-Rekrutimit.

- b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel-Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes etj.
- c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të MM-së, jo më pak se 150 ditë përpëra nga data e fillimit të stërvitjes individuale bazë.

4. Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin në QPR.

4.1 Kandidatët për ushtarë/detarë aktivë, paraqesin në Qendrën e Personel-Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:

a. Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është:

- kërkesë me shkrim, në të cilën parashtronhet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, jo më pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit);
- fotokopje të kartës së identitetit;
- certifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin qeveritar e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi;
- dy fotografji të përmasave 4x6 cm dhe dy fotografji të përmasave 9x12 cm;
- fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar e noterizuar dhe certifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit ose të arsimit të lartë të noterizuar;
- diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njojen e gjuhëve të huaja, të noterizuara;
- Raport mjekësor të lëshuar nga komisioni mjekoligjor (KML) i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit shoqëruar edhe me një raport ose vërtetim nga mjeku i familjes ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale të jetës.
- Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrrethet ku banojnë.
- Në momentin e aplikimit, pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel-Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtar/detar aktiv dhe formularin e vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore (Aneksi C), bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b. Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit.

Nëse kandidati shpallet fitues brenda 2 (dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga prokuroria;
- vërtetim nga gjykata;
- raport mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor Ushtarak i Njësisë Mjekësore Ushtarake, në përfundim të ekzaminimeve.

4.2 Qendra e Personel-Rekrutimit, në bashkëpunim me strukturat që kanë akses në portalin e-albania, të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur, për arsyen teknike, ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit.

4.3 Qendra e Personel-Rekrutimit vijon procedurat e testimit dhe përgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas germës “a”, të pikës 4.1., Kreu II.

5. Fazat dhe procedurat e konkurrimit.

Për t'u rekrutuar në FA, të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë disa standarde për edukimin, gjendjen fizike dhe gjendjen shëndetësore. Zhvillimi i konkurrimit përfshin:

- testimini fizik;
- testimini intelektual;
- testimini psikologjik;
- ekzaminimin shëndetësor;
- testimi profesional (vetëm për personelin e orkestrës frymore)

5.1. Komisionet dhe përbërja e tyre.

Për testimin dhe vlerësimin e kandidatëve krijohen komisionet e mëposhtme:

5.1.1 Komisioni i testimit fizik, i cili ka në përbërje të tij:

- një oficer të QPR-së, nënkolonel/major, kryetar;
- një instruktörë të përgatitjes fizike të KDS-së, anëtar;
- dy specialistë të testimit nga QPR-ja, anëtar
- një përfaqësues të SHP-së nga J-3/7, anëtar.

5.1.2 Komisioni i testimit intelektual, i cili ka atributet e Komisionit Qendoror, ka në përbërjen e tij:

- një oficer i QPR-së me gradën nënkolonel, kryetar;
- një oficer i QPR me gradën kapiten, anëtar;

- një specialist i QPR-së për testimin intelektual, anëtar.

5.1.3 Komisioni i testimit psikologjik, i cili ka në përbërje të tij:

- një oficer i QPR-së me gradën major, kryetar;
- një specialist i testimit psikologjik nga DMBNJSH, anëtar;
- një oficer me gradën kapiten i QPR-së, anëtar.

5.1.4 Komisioni i ekzaminimit shëndetësor, i cili përbëhet nga 3 (tre) mjekë të Njësisë Mjekësore Ushtarake.

5.1.5 Komisioni i shqyrtimit të ankesave, i cili përbëhet nga:

- një nënkolonel, përfaqësues i SHP (J-1), kryetar;
- një nënkolonel, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- një nënöficer me gradën kapter, përfaqësues i QPR-së, anëtar.

5.1.6 Komisioni i testimit profesional (vetëm për testimin e rekrutëve të orkestrës frymore)

- “Këshilli Artistik” i Batalionit të Shtabit të Përgjithshëm ushtron funksionet e komisionit të testimit profesional për rekrutimin e personelit ushtar të orkestrës frymore.

5.1.7 Komisionet ngrihen me urdhër të komandantit të QPR-së.

5.1.8 Për zhvillimin e testimeve, QPR-ja i kërkon SHPFA-së që ta mbështesë me personelin dhe specialistët e nevojshëm.

5.2. Testimi fizik.

5.2.1.1 Testimi fizik është hapi i parë i konkurrimit. Ai ka si qëllim të verifikojë standarde fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u rekrutuar si ushtarë/datarë në FA.

5.2.2 Kandidatët i nënshtrohen testimit fizik në disiplinat e mëposhtme:

- vrapim 1000 m;
- ulje-ngritje mbi krahë (pompa);
- palosje-shpalosje.

5.2.3 Testimi fizik zhvillohet nën mbikëqyrjen e komisionit të testimit fizik, sipas normave të përcaktuara në Aneksin A, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

5.2.4 Kandidati për ushtar/datar aktiv duhet të marrë minimumi 60 pikë për çdo disiplinë të përgatitjes fizike, për të vijuar konkurremin e mëtejshëm.

5.2.5 Në testin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive të siguruara prej tij (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete);

5.2.6 Testimi fizik zhvillohet në prani të ambulancës dhe ekipit mjekësor. Ai zhvillohet në disa sesione dhe për disa ditë;

5.2.7 Pas çdo sesioni të testimit fizik, kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka marrë më shumë pikë. Listat e rezultateve, pasi firmosen nga anëtarët e komisionit, i dërgohet Komandantit të QPR-së dhe hidhen brenda ditës në Sistemin e Automatizuar të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rezultatet u bëhen të ditura kandidatëve;

5.2.8 Pas përfundimit të testimit fizik nëpërmjet Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore gjenerohet “Raporti i rezultateve të testimit fizik”. Raporti përban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, gjatësinë, gjininë (mashkull ose femër), disiplinat e testimit, normat e arritura dhe sasinë e pikëve për çdo disiplinë, pikët totale të marra në testimin fizik, si dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit fizik “kalues” ose “mbetës”.

5.2.9 Kandidatët që rezultojnë mbetës ndërpresin konkurrimin e mëtejshëm.

5.3. Testimi intelektual

5.3.1 Nëpërmjet testimit intelektual, synohet të vlerësohen niveli i njohurive dhe kulturës së përgjithshme, aftësitë përfshirë gjuhar, vepruar, aftësitë e përqendrimit të vëmendjes, si dhe niveli i përgjithshëm i inteligjencës.

5.3.2 Testimi intelektual kryhet nën mbikëqyrjen e komisionit të testimit intelektual, pas kualifikimit në testin e përgatitjes fizike. Ai zhvillohet në mënyrë elektronike në dy sesione: testimi i përgjithshëm intelektual dhe testimi sipas specialitetave.

5.3.3 **Testi intelektual i përgjithshëm** përfshin verifikimin e njohurive në fushat e mëposhtme:

- arsyetim aritmetik;
- njohja e kuptimit të fjaleve;
- të kuptuarit e paragrafëve;
- njohuri matematikore;
- njohuri të kulturës së përgjithshme

5.3.4 Fushat e testimit intelektual të përgjithshëm, përbajtja e tyre, sasia e pyetjeve për çdo fushë, koha maksimale përfshirë zhvillimin e testimit përfshirë çdo fushë dhe kodit i tyre jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Fusha e testimit	Koha	Sasia e pyetjeve	Kodi	Përbajtja e fushave të testimit
1.	Arsyetim aritmetik.	36	30	AA	Vlerësohen njohuritë për zgjidhjen e problemeve bazë matematikore.
2.	Njohja e kuptimit të fjalëve.	7	20	NKF	Vlerësohen aftësitë për të kuptuar përbajtjen/kuptimin e fjalëve nëpërmjet sinonimeve.
3.	Kuptimi i paragrafëve.	9	10	KP	Vlerësohen aftësitë për të kuptuar ose nxjerrë informacione nga materiale ose paragrafë të shkruar.
4.	Njohuri matematikore.	24	25	NM	Vlerësohen njohuritë matematikore në fushën e koncepteve dhe aplikimit.
5.	Njohuri të kulturës së përgjithshme.	8	20	NKP	Vlerësohen njohuritë në fushën e historisë, gjuhës shqipe, letërsisë, kushtetutës, ushtrisë, gjeografisë dhe aktualitetit.

5.3.5 Testi intelektual i përgjithshëm është test kualifikues për t'u bërë pjesë e FA-së (TKFA).

Ai është ndërtuar me 105 pyetje, të cilat në total kanë 155 pikë. Çdo kandidat duhet të arrije minimumi 70 pikë për t'u kualifikuar.

5.3.6 Vlerësimi i çdo kandidati dhe kualifikimi i tij bëhet në mënyrë automatike nëpërmjet sistemit. Në përfundim të testimit, kompjuteri gjeneron për çdo kandidat sasinë e pikëve dhe konfirmon nëse kandidati është kualifikuar ose jo (Pass or No).

5.3.7 Në përfundim të testimit intelektual të përgjithshëm nëpërmjet sistemit gjenerohet “Raporti i rezultateve të testimit intelektual të përgjithshëm”, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i përcillet komandanit të QPR-së. Kandidatët listohen sipas pikëve, duke filluar nga ai që ka siguruar më shumë pikë.

5.3.8 Me kandidatët e kualifikuar zhvillohet sesioni i dytë i testimit intelektual, **testimi intelektual për specialitetet**. Ai zhvillohet menjëherë pas testit intelektual të përgjithshëm, për vlerësimin e njohurive në fushat e mëposhtme:

- shkencat e përgjithshme;
- mekanikën dhe automatizimin;
- elektronikën dhe informacionin;
- shërbimet mekanike.

5.3.9 Fushat e testimit intelektual për specialitetet, përbajtja e tyre, sasia e pyetjeve për çdo fushë, koha maksimale për zhvillimin e testimit për çdo fushë dhe kodi i tyre jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fusha e testimit	Koha	Pyetje	Kodi	Përbajtja e fushave të testimit
1.	Shkencat e përgjithshme.	11	25	SHP	Vlerësohen njohuritë në shkencat shoqërore, hapësinore, në fizikë dhe biologji.
2.	Informacion auto dhe shop oficinë	11	25	IAO	Vlerësohen njohuritë për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve për materialet, si druri dhe metalet.
3.	Informacion elektronik.	9	20	EI	Vlerësohen njohuritë mbi elektricitetin, rrymën elektrike, qarqet, pajisjet dhe sistemet elektronike.
4.	Të kuptuarit e mekanikës dhe automatikës	19	25	KM	Vlerësohen njohuritë mbi mekanikën dhe pajisjet kryesore mekanike.

5.3.10 Rezultatet e testimit për specialitetet shërbejnë për të përcaktuar se cili specialitet është më i përshtatshëm për kandidatët që janë kualifikuar në testin e përgjithshëm intelektual.

5.3.11 Kandidati duhet të arrijë një minimum pikësh që të kualifikohet për specialitetin përkatës. Vlerësimi për specialitetet bëhet mbi bazën e kombinimit të njohurive të testimit të përgjithshëm intelektual dhe njohurive nga fushat e testimit për specialitetet. Kombinimi i njohurive varet nga lloji i specialitetit. Minimumi i pikëve që duhet të sigurojnë kandidatët është i ndryshëm për specialitetet të ndryshme. Përbërja dhe minimumi i pikëve që kandidati duhet të sigurojë sipas specialitetave jepet në **Aneksin B**, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Rezultatet në pikë të testimit sipas specialitetave dhe pikët sipas kombinimeve nuk afishohen nga kompjuteri. Fituesit për specialitetin gjenerohen drejtpërdrejt nga sistemi kompjuterik.

5.3.12 Në përfundim të testimit sipas specialitetave nëpërmjet sistemit gjenerohet “Raporti i rezultateve të kombinuara të testimit intelektual të përgjithshëm dhe testimit intelektual sipas specialitetave”.

5.3.13 Një kopje e këtij raporti i dërgohet J-1 në SHP, i cili e përdorë atë për ndarjen e ushtarëve/datarëve sipas specialitetave në përfundim të Stërvitjes Individuale Bazë.

5.4. Testimi psikologjik.

5.4.1 Testimi psikologjik zhvillohet me qëllim që të verifikojë te kandidatët përgjegjshmërinë, motivimin, aftësinë e të menduarit dhe të gjykuarit, si dhe stabilitetin e sjelljes.

5.4.2 Testi psikologjik zhvillohet nën mbikëqyrjen e komisionit të testimit psikologjik. Ai zhvillohet pas testimit intelektual.

5.4.3 Testi psikologjik zhvillohet në formë interviste dhe është skualifikues. Në çdo rast, arsyet e skualifikimit të kandidatëve motivohen me shkrim.

5.4.4 Në përfundim të testimit psikologjik, komisioni përkatës i dërgon komandantit të QPR-së “Raportin e rezultateve të testimit psikologjik”. Raporti përmban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, rezultatet e testimit psikologjik dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit psikologjik “kalues” ose “mbetës”.

5.4.5 Pas hedhjes së rezultateve të testimit psikologjik në sistemin e automatizuar të të dhënave nëpërmjet sistemit gjenerohet “Raporti i kandidatëve fitues në testimin fizik, intelektual dhe psikologjik”, i cili do t’i dërgohet zyrtarisht NJMU-së për kryerjen e kontrollit shëndetësor të kandidatëve, brenda dy ditëve nga nxjerra e rezultateve.

5.5. Ekzaminimi shëndetësor.

5.5.1 Ekzaminimi shëndetësor i kandidatëve për ushtarë/datarë aktivë, kryhet nga Njësia Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës. Ai kryhet me kandidatët që kanë dalë fitues, pas përfundimit të testimit fizik, intelektual dhe psikologjik, sipas listës së dërguar nga Komandanti i QPR-së.

5.5.2 Ekzaminimi shëndetësor bëhet në bazë të “Rregullores së vlerësimit të aftësive fiziko-shëndetësore të shtetasve dhe ushtarëve të FA-së”, të miratuar me urdhër të MM-së nr. 381, datë 09.07.2004 dhe urdhrit të ministrit të Shëndetësisë nr. 2253, datë 17.06.2004.

Ekzaminimi shëndetësor përfshin:

- këqyrjen fizike;
- ekzaminimin e përgjithshëm;
- vizitë okulist;
- vizitë kardiologu;
- vizitë neurologu
- vizitë psikiatri;
- vizitë psikologu;
- vizitë kirurgu;
- vizitë ortopedi;
- vizitë alergologu;
- vizitë endokrinologu;
- vizitë infekzionisti;
- vizitë gastrohepatologu;
- vizitë hematologu;
- vizitë ORL;
- vizitë pneumologu;

5.5.3 Në rast se specialistët mjek të komisionit gjykojnë të nevojshme, mund të kërkojnë ekzaminime të tjera shtesë për:

- ekzaminimet biokimike;
- analizën e urinës;
- grupin e gjakut
 - Rezus
 - HBSAg;
 - Anti HCV;
 - HIV;
 - Testi i Sifilizit.

5.5.4 Ekzaminimi shëndetësor kryhet brenda 2 javëve nga dërgimi i listës nga ana e QPR-së.

5.5.5 Në përfundim të ekzaminimeve të kryera, komisioni mjekësor vendos nëse kandidati është i aftë për të shërbyer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose jo. Kandidatët që rezultojnë të paaftë nga ana shëndetësore nuk mund të bëhen pjesë e FA-së.

5.5.6 Brenda dy ditëve nga përfundimi i kontrollit shëndetësor, Spitali Universitar i Traumës (Njësia Mjekësore Ushtarake) i dërgon me shkrim QPR-së emrat dhe raportet mjekësore të kandidatëve.

5.5.7 Rezultatet e ekzaminimeve mjekësore hidhen nga komisioni përkatës në sistemin e automatizuar të të dhënave.

6. Testimi profesional.

- 6.1 Testimi profesional zhvillohet me personelin që rekrutohet për plotësimin e nevojave të orkestrës frymore me ushtarë aktivë.
- 6.2 Testimi zhvillohet nga Këshilli Artistik i Orkestrës Frymore, të Batalionit të Shtabit të Përgjithshëm.
- 6.3 Testimi zhvillohet në formën e testimit praktik.
- 6.4 Testimi profesional është skualifikues për personelin e orkestrës frymore.
- 6.5. Shtetasit që nuk arrijnë të kualifikohen si rekrut të orkestrës frymore, me pëlqimin e tyre, mund të rekrutohen si rekrutë për specialitetet e tjera, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Procedura e zgjidhjes së ankesave.

- 7.1 Kandidatët kanë të drejtë që, brenda 2 ditëve nga shpallja e rezultateve, të ankohen me shkrim në Qendrën e Personel-Rekrutimit në lidhje me rezultatet e vlerësimit.

- 7.2 Komisioni i ankesave, i ngritur pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit, shqyrton ankesat brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të ankimimit dhe i kthen përgjigje me shkrim të interesuarve brenda 24 orëve nga përfundimi i shqyrtimit të ankesave.
- 7.3 Procedura e zgjidhjes së ankesave dokumentohet zyrtarisht.
- 7.4 Kandidatët që rezultojnë fitues pas procesit të shqyrtimit të ankesave integrohen në listën e fituesve dhe dërgohen në Njësinë Mjekësore Ushtarake për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore.

8. Shpallja e fituesve.

- 8.1 Konsiderohen fitues të gjithë kandidatët që janë kualifikuar në përfundim të të gjitha testimeve të zhvilluara dhe që kanë rezultuar të aftë nga ana shëndetësore pas ekzaminimit mjekësor.
- 8.2 Raporti i rezultateve përfundimtare shpallet nga QPR-ja në faqen e internetit të MM-së dhe në një vend të dukshëm pranë QPR-së, brenda 24 orëve përfundimi i shqyrtimit të ankesave.
- 8.3 Brenda afatit të shpalljes së rezultateve, QPR-ja i dërgon me shkresë zyrtare Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm “Raportin e rezultateve përfundimtare”.
- 8.4 QPR-ja sipas planit të dërguar nga SHSHPFA, mbi bazën e raportit të rezultateve përfundimtare dhe përgjigjes së AISM dhe PU për plotësimin e kushtit të sigurisë, dërgon në Drejtorinë e Personelit në SHP dhe KDS, listën e kandidatëve fitues që janë përzgjedhur për ushtarë/datarë, të cilët do të kryejnë stërvitjen individuale bazë në Shkollën e Trupës.
- 8.5 J-1 në SHP, në përputhje me planin e rekrutimit, përgatit urdhrin e SHSHPFA-së, “Për ndjekjen e kursit të stërvitjes individuale bazë për ushtarët/datarë aktiv”, në Shkollën e Trupës, pas verifikimit të bërë nga AISM-ja dhe PU-ja. Kandidatët që nuk plotësojnë kushtin e sigurisë nuk bëhen pjesë e urdhrit.

9. Procedurat e titullimit, gradimit dhe emërimit ushtar/datar aktiv

- 9.1 Në bazë të ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura”, nenit 12, pika 3, rekrutët në përfundim të stërvitjes bazë certifikohen dhe titullohen në “ushtar/datar” aktiv. Titullimi bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, sipas propozimit të komandantit të Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale, i cili ka certifikuar rekrutin në përfundim të kursit.

- 9.2 Në qoftë se kandidati për ushtar/detar nuk certifikohet në përfundim të stërvitjes bazë, ai nuk titullohet “ushtar/detar aktiv”.
- 9.3 J-1 në SHP për ushtarët që nuk certifikohen dhe titullohen “ushtar/detar” aktiv, përgatit urdhrin e ndërprerjes shërbimit aktiv nga FA-ja;
- 9.4 Në përfundim të kursit, Komandanti i Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale, i përcjell SHSHP-së, nëpërmjet KDS-së, propozimet për titullimin e rekrutëve “ushtarë/detarë aktivë”;
- 9.5 Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, bazuar në propozimin e Komandantit të Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale, përgatit praktikën për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për titullimin e rekrutëve ushtarë/detarë aktivë dhe gradimin e tyre në “ushtar/detar aktiv I” ose “ushtar/detar aktiv II”, për rekrutët që janë me arsim të lartë;
- 9.6 Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, pas titullimit dhe gradimit të rekruteve nga SHSHP-ja, përgatit urdhrat për shpërndarjen e ushtarëve në FA (ose kalimin në emërtesë të strukturave të FA-së) për emërimin në detyrë, në përputhje me planin e shpërndarjes. Një kopje e urdhraleve dërgohet në çdo strukturë, si dhe në QPR, për t'u administruar në dosjen personale të ushtarit/detarit;
- 9.7 Në bazë të urdhraleve të SHSHPFA-së për kalimit në emërtesë e shpërndarjes së tyre në strukturat e FA-së dhe pas konfirmimit të urdhraleve të emërimit nga forcat/repartet, QPR-ja dërgon një kopje të dosjes të kandidatit për ushtar/detar aktiv, në strukturën përkatëse, ku ata janë emëruar;
- 9.8 Rekrutët, 10 ditë para përfundimit të stërvitjes individuale bazë në Shkollën e Trupës, duhet të plotësojnë formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën elektronike www.mod.gov.al/bazaligjore dhe bëhet pjesë e dosjes së çdo rekruti.

10. Kontrata me Forcat e Armatosura.

- 10.1 Në bazë të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarakë në FA të RSH-së”, nen 9, pika 1, kontrata e shërbimit për ushtarët/detarët aktivë nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të FA-së nënshkruajnë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura. Kontrata nënshkruhet me titullimin “ushtar/detar” aktiv;
- 10.2 Për periudhën e stërvitjes individuale bazë nënshkruhet kontratë midis komandantit të Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale dhe kandidatit për ushtar.

11. Dispozita të fundit.

- 11.1 Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë, Qendra e Personel-Rekrutimit, AISM-ja, Njësia Mjekësore Ushtarake, drejtoreti në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së;
- 11.2 Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe sekretari Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.
- 11.3 Udhëzimi i ministrit të Mbrojtjes nr. 4, datë 02.02.2017 “Për procedurën dhe kriteret për rekrutimin e ushtarëve/datarëve aktivë në Forcat e Armatosura”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR USHTAR/DETAR AKTIV NË FORCAT E ARMATOSURA

A) TË DHËNAT PERSONALE:

1. Emri:Atësia:.....Mbiemri:
2. Nr. i kartës së identitetit:
3. Gjinia: Mashkull Femër Gjatësia:
4. Datëlindja:.....Vendlindja:.....Vendbanimi.....
5. Kombësia:Shtetësia:

B) ADRESA/KONTAKT:

1. Adresa e vendbanimit:
.....
2. Numri i telefonit fiks:cel:
3. E - mail:.....

C) TË DHËNA MBI ARSIMIMIN:

1. Arsimi i kryer:
 Parauniversitar
 I lartë
2. Lloji i arsimit parauniversitar:
 I përgjithshëm
 Profesional
■ Institucioni arsimor ku keni kryer arsimin parauniversitar:
.....
(shëno emërtimin e shkollës, qytetit/fshatit)
- Nota mesatare e arsimit parauniversitar të përgjithshëm:.....
- Nota mesatare e arsimit profesional:.....

- Arsimi profesional:.....
(Shëno llojin e arsimit profesional të kryer)
3. Lloji i arsimit të lartë:
- Publik
 - Privat
4. Diploma që zotëroni:
- Bachelor
 - Master profesional
 - Master shkencor
5. Universiteti/Fakulteti/dega:.....
6. Koha e kryerjes së studimeve të larta:.....

Ç) TË DHËNA TË TJERA:

1. A keni kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv:
- Po
 - Jo
2. Nëse e keni kryer, plotëso, si më poshtë:
- Repartin ushtarak ku e keni kryer shërbimin:.....
 - Adresën:.....
 - Specialitetin:.....
 - Koha e kryerjes së shërbimit (fillim/mbarim, muaji, viti).....
3. Forca/brigada/reparti ushtarak ku dëshironi të shërbeni: (shëno me X)
- | | |
|--|--------------------------|
| ▪ Forcën Tokësore | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Forcën Ajrore | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Forcën Detare | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Komandën e Mbështetjes | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Policinë Ushtarake të FA-së | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit | <input type="checkbox"/> |
| ▪ Batalioni i Mbështetjes së Shtabit Përgjithshëm | <input type="checkbox"/> |

4. Lexoni me kujdes secilën pyetje dhe vendlodni shenjën “x” në njëren nga kolonat e mëposhtme, Po ose Jo.

	Pyetjet	Po	Jo
Pyetja 1	A keni ndryshuar emrin apo mbiemrin më parë?		
Pyetja 2	A keni shtetësi tjetër përvèç asaj shqiptare?		
Pyetja 3	A keni shërbyer më parë në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë?		
Pyetja 4	A keni aplikuar ndonjëherë tjetër për të shërbyer në Forcat e Armatosura?		
Pyetja 5	A jeni këshilluar ndonjëherë me psikolog apo mjek psikiatër?		
Pyetja 6	A jeni në marrëdhënie pune?		
Pyetja 7	Nëse keni qenë herë tjetër në marrëdhënie pune dhe jeni larguar prej saj.		
Pyetja 8	A keni njojuri në ndonjë gjuhe të huaj?		
Pyetja 9	Jeni i gatshëm të pranoni për të shërbyer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në operacione ushtarake ndërkombëtare?		
Pyetja 10	Do të dëshironit që ta zhvillon edhe më tej karrierën tuaj, duke shërbyer edhe si nënëoficer?		
Pyetja e 11	A keni qenë i depërtuar ndonjëherë nga vendet e tjera?		

D) MOTIVI QË JU SHTYN TË SHËRBENI NË FORCAT E ARMATOSURA.

Shkruani me shkrim dore me rrëth 100 fjalë, përse dëshironi të shërbeni në Forcat e Armatosura, çfarë dini për Forcat e Armatosura, për Forcen, brigadën, repartin ku doni të shërbeni dhe për specialitetin që keni zgjedhur.

Për sa më sipër, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se informacioni që kam shënuar në këtë formular aplikimi është i vërtetë, i saktë dhe është dhënë me vullnetin tim të lirë. Jam i hapur ndaj autoriteteve kompetente për të bërë verifikimin e nevojshëm.

Aplikanti

(
Emri Atësia Mbiemri, Nënshtkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

FORMULAR I PRANIMIT
TË DOKUMENTACIONIT TË APLIKANTIT PËR USHTAR/DETAR AKTIV

I. TË DHËNA PERSONALE:

- Emri.....Atësia.....Mbiemri.....
- Datëlindja.....Vendlindja.....Vendbanimi.....
- Numri i kartës së identitetit.....

II. VERIFIKIMI I DOKUMANTACIONIT.

Specialistët e Seksionit të Rekrutimit, pranë QPR-së, pasi verifikuan pyetësorin e aplikimit për ushtar/detar aktiv, të plotësuar nga aplikanti, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e tij, verejnë se:

- Aplikanti ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të udhëzimit.
 Aplikanti nuk ka dorëzuar:
(specifikohet dokumentacioni që nuk ka paraqitur ose parregullsitë e vërejtura)

- Aplikanti plotëson kriteret për vijimin e procedurave të testimit.
 Aplikanti nuk plotëson kriteret për vijimin e procedurave të testimit

(specifikoher shkaqet e mosplotësimit të kritereve)

Me qëllim vijimin e procedurave të testimit, bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti _____, si më poshtë:

(Emri Atësia Mbiemri)

1. Kërkesën me shkrim;
2. Fotokopje të kartës së identitetit;
3. Certifikatën familjare, 1 copë;
4. Dy fotografi të përmasave 4x6 cm;
5. Dy fotografi të përmasave 9x12 cm.

6. Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit dhe të noterizuara ose të arsimit të lartë (nëse ka) të noterizuar;
7. Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka);
8. Patentë për drejtim automjeti (nëse ka);
9. Raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjekoligjor (KML) i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, shoqëruar edhe me një raport ose vërtetim nga mjeku i familjes;
10. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut;
11. Formalarin e aplikimit për ushtar/detar aktiv;
12. Formularin e pranimit të dokumentacionit të aplikantit;
13. Formularin e vetëdekclarimit të gjendjes shëndetësore, Aneksi C.

Specialisti i rekrutimit

(Grada Emri Mbiemri, Nënshkrimi)

Aplikanti

(Emri Mbiemri, Nënshkrimi)

Shënim: Dokumentacioni i aplikantit i plotësuar pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit nga aplikanti, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar prej tij, është pjesë e pandarë e dosjes personale të kandidatit për ushtar/detar aktiv.

Mora njoftim se testet dhe procedurat e testimit për rekrutimin si ushtar/detar aktiv do të zhvillohen në Qendrën e Personel-Rekrutimit, në datën _____. _____. _____.

Tiranë, më _____. _____. 201____

ANEKSI "A"

POMPA, PALOSJE/SHPALOSJE DHE VRAPIM 1000m MESHKUJ/FEMRA

Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra	
Pompa	Pikët	Pompa	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët
58	100	33	100	71	100	65	100	4'05"	100	4'20"	100
57	99	32	98	70	99	64	99	4'06"	99	4'21"	99
56	98	31	96	69	98	63	98	4'07"	98	4'22"	98
55	97	30	94	68	97	62	97	4'08"	97	4'23"	97
54	96	29	92	67	96	61	96	4'09"	96	4'24"	96
53	95	28	90	66	95	60	95	4'10"	95	4'25"	95
52	94	27	88	65	94	59	94	4'11"	94	4'26"	94
51	93	26	86	64	93	58	93	4'12"	93	4'27"	93
50	92	25	84	63	92	57	92	4'13"	92	4'28"	92
49	91	24	82	62	91	56	91	4'14"	91	4'29"	91
48	90	23	80	61	90	55	90	4'15"	90	4'30"	90
47	89	22	78	60	89	54	89	4'16"	89	4'31"	89
46	88	21	76	59	88	53	88	4'17"	88	4'32"	88
45	87	20	74	58	87	52	87	4'18"	87	4'33"	87
44	86	19	72	57	86	51	86	4'19"	86	4'34"	86
43	85	18	70	56	85	50	85	4'20"	85	4'35"	85
42	84	17	68	55	84	49	84	4'21"	84	4'36"	84
41	83	16	66	54	83	48	83	4'22"	83	4'37"	83
40	82	15	64	53	82	47	82	4'23"	82	4'38"	82
39	81	14	62	52	81	46	81	4'24"	81	4'39"	81
38	80	13	60	51	80	45	80	4'25"	80	4'40"	80
37	79	12	59	50	79	44	79	4'26"	79	4'41"	79
36	78	11	58	49	78	43	78	4'27"	78	4'42"	78
35	77	10	57	48	77	42	77	4'28"	77	4'43"	77
34	76	9	56	47	76	41	76	4'29"	76	4'44"	76
33	75	8	55	46	75	40	75	4'30"	75	4'45"	75
32	74	7	54	45	74	39	74	4'31"	74	4'46"	74
31	73	6	53	44	73	38	73	4'32"	73	4'47"	73
30	72	5	52	43	72	37	72	4'33"	72	4'48"	72
29	71	4	51	42	71	36	71	4'34"	71	4'49"	71
28	70	3	50	41	70	35	70	4'35"	70	4'50"	70
27	69	2	49	40	69	34	69	4'36"	69	4'51"	69
26	68	1	48	39	68	33	68	4'37"	68	4'52"	68
25	67			38	67	32	67	4'38"	67	4'53"	67
24	66			37	66	31	66	4'39"	66	4'54"	66
23	65			36	65	30	65	4'40"	65	4'55"	65
22	64			35	64	29	64	4'41"	64	4'56"	64
21	63			34	63	28	63	4'42"	63	4'57"	63
20	62			33	62	27	62	4'43"	62	4'58"	62
19	61			32	61	26	61	4'44"	61	4'59"	61
18	60			31	60	25	60	4'45"	60	5'00"	60
17	59			30	59	24	59	4'46"	59	5'01"	59
16	58			29	58	23	58	4'47"	58	5'02"	58
15	57			28	57	22	57	4'48"	57	5'03"	57
14	56			27	56	21	56	4'49"	56	5'04"	56
13	55			26	55	20	55	4'50"	55	5'05"	55
12	54			25	54	19	54	4'51"	54	5'06"	54

11	53			24	53	18	53	4'52"	53	5'07"	53
10	52			23	52	17	52	4'53"	52	5'08"	52
9	51			22	51	16	51	4'54"	51	5'09"	51
8	50			21	50	15	50	4'55"	50	5'10"	50
7	49			20	49	14	49	4'56"	49	5'11"	49
6	48			19	48	13	48	4'57"	48	5'12"	48
5	47			18	47	12	47	4'58"	47	5'13"	47
4	46			17	46	11	46	4'59"	46	5'14"	46
3	45			16	45	10	45	5'00"	45	5'15"	45
2	44			15	44	9	44	5'01"	44	5'16"	44
1	43			14	43	8	43	5'02"	43	5'17"	43
				13	42	7	42	5'03"	42	5'18"	42
				12	41	6	41	5'04"	41	5'19"	41
				11	40	5	40	5'05"	40	5'20"	40
				10	39	4	39	5'06"	39	5'21"	39
				9	38	3	38	5'07"	38	5'22"	38
				8	37	2	37	5'08"	37	5'23"	37
				7	36	1	36	5'09"	36	5'24"	36
				6	35			5'10"	35	5'25"	35
				5	34			5'11"	34	5'26"	34
				4	33			5'12"	33	5'27"	33
				3	32			5'13"	32	5'28"	32
				2	31			5'14"	31	5'29"	31
				1	30			5'15"	30	5'30"	30
								5'16"	29	5'31"	29
								5'17"	28	5'32"	28
								5'18"	27	5'33"	27
								5'19"	26	5'34"	26
								5'20"	25	5'35"	25
								5'21"	24	5'36"	24
								5'22"	23	5'37"	23
								5'23"	22	5'38"	22
								5'24"	21	5'39"	21
								5'25"	20	5'40"	20
								5'26"	19	5'41"	19
								5'27"	18	5'42"	18
								5'28"	17	5'43"	17
								5'29"	16	5'44"	16
								5'30"	15	5'45"	15
								5'31"	14	5'46"	14
								5'32"	13	5'47"	13
								5'33"	12	5'48"	12
								5'34"	11	5'49"	11
								5'35"	10	5'50"	10
								5'36"	9	5'51"	9
								5'37"	8	5'52"	8
								5'38"	7	5'53"	7
								5'39"	6	5'54"	6
								5'40"	5	5'55"	5
								5'41"	4	5'56"	4
								5'42"	3	5'57"	3
								5'43"	2	5'58"	2
								5'44"	1	5'59"	1

ANEKSI-B

**KODET DHE PERBËRJA E PIKËVE TË KOMBINURA PËR REKRUTIMIN E USHTARËT/DETARËT AKTIV
SIPAS SPECIALITETEVE**

Nr	Kodi		Specialiteti	Komponetet				Rezultati
	Alfa	Numerik		I	II	III	IV	
1	KE	1100	Këmbsori	AA	IOA	KM	-	LU 48
2	PU	1150	Policia Ushtarake	SHP	VE	NM	KM	MT 78
3	PU	1152	Policia Ushtarake/Ruajtje	SHP	VE	NM	KM	MT 81
4	PK	1154	Policia Kriminale/Gjyqësore	SHP	VE	NM	KM	MT 88
5	PT	1155	P. Kontrollit të Trafikut. Lëvizjes	SHP	VE	NM	KM	MT 78
6	AT	1210	Artileri Tokësore	AA	IOA	KM	-	LU 48
7	AN	1438	Radiometrist	SHP	VE	NM	KM	MT 81
8	AN	1439	Përgjegjës Kuverte	IOA	KM	IE	-	MM 46
9	AN	1445	Operator i Vëzhgimit Detar	VE	AA	-	-	TP 48
10				IAO	KM	IE	-	MM 46
11	AN	1462	Polumbar	SHP	IOA	NM	IE	MP 62
12				VE	AA	-	-	TP 56
13				SHP	VE	NM	KM	MT 88
14	ZB	1810	Zbulim i Përgjithshëm	SHP	VE	NM	KM	MT78
15	SN	1900	Specialit Moti	SHP	AA	NM	IE	EL 63
16	LT	2150	Shofer	VE	IAO	KM	-	OU 60
17	LT	2151	Xhenjer i paisjeve të rënda	SHP	IAO	NM	IE	MP 57
18	LM	2200	Armatim -Municion	SHP	VE	NM	KM	MT81
19	LM	2230	Skatërrim municionesh	SHP	IAO	NM	IE	MP 67
20	LF	2300	Furnizim	VE	AA	NM	-	AD 66
21	LF	2370	Guzhinjer	VE	IAO	KM	-	OU 60
22	LI	2390	Infrastr.(Shërbime)	SHP	IAO	NM	IE	MP 57
23	LR	2400	Mirmbajtje	IAO	KM	IE	-	MM 42
24	LR	2410	M. Mjeteve të transportit	IAO	KM	IE	-	MM 42

25	LR	2430	M.Mjeteve Aviacionit	IAO	KM	IE	-	MM 49
26	LR	2470	Mirmbajtje e Përgjithshme	IAO	KM	IE	-	MM 42
27	LR	2477	Elekriçist	SHP	AA	NM	IE	EL 63
28	LR	2479	Motorist	IOA	KM	IE	-	MM 49
29	KI	2630	MADM	SHP	VE	NM	KM	MT 78
30	XH	3200	Xhenjo	SHP	IAO	NM	IE	MP 59
31	MZ	3213	MNZ	SHP	IAO	NM	IE	MP 57
32	XH	3250	Xhenjo në luftim	AA	IAO	KM	-	LU 48
33	ND	3400	Ndërlidhje	VE	AA	IAO	KM	VN 81
34	ND	3420	Ndërlidhje, Radio Telefon	VE	AA	IAO	KM	VN 85
35				SHP	AA	NM	IE	EL 70
36	ND	3426	Teknologji Informacioni	SHP	VE	NM	KM	MT 81
37	AD	3500	Administrim	VE	AA	NM	-	AD 66
38	KU	3580	Muzikant	Vlerësohet në bazë të instrumentit				
39	RU	3600	Ruajtja	AA	IAO	KM	-	LU 48
40	MJ	4141	Infermier	SHP	VE	NM	KM	MT 78

ANEKSI C

**FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR GJENDJEN SHËNDETËSORE TË
KANDIDATIT PËR USHTAR/DETAR AKTIV**

Emri _____ Atësia _____ Mbiemri _____
 Datëlindja _____. _____. _____. _____

Nr.	Probleme shëndetësore	Po	Jo
1.	A keni marrë goditje në kokë këto 5 vitet e fundit?		
2.	A keni pasur ndonjë tronditje apo lëndim të kokës brenda 6 muajve të fundit?		
3.	A keni pasur ndërhyrje kirurgjikale dentare brenda muajit të fundit?		
4.	A keni kryer ndërhyrje kirurgjikale në trupin tuaj?		
5.	A keni pasur thyerje të kockave të ndryshme të trupit brenda 1 viti?		
6.	A keni marrë apo jeni duke marrë mjekim kundër përdorimit të alkolit apo substancave narkotike të ndryshme?		
7.	A keni ndonjë shqetësim neurologjik apo psikologjik që lidhet me mirëfunksionimin e organizmit tuaj?		
8.	A keni pasur ndonjë shqetësim shëndetësor në zemër apo të tensionit arterial?		
9.	A keni pasur apo keni ndonjë çrrégullim apo infeksion të organeve të dëgjimit (veshit) dhe frysëmarjes (hundës) në muajin e fundit?		
10.	A keni pasur probleme të tjera shëndetësore (nëse po specifiko problemi)?		

Shtetasi

 (Emri Atësia Mbiemri)